



Data: 01.04.2019

Ref.: 540/19_D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 64-të, të mbajtur më 08 mars 2019, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet ankesa Nr.354/19H, datë 04.03.2019 e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", si e bazuar, anulohet vendimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Nr.142/19D, datë 05.02.2019.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Me qëllim të plotësimit të kriterëve formale për staf akademik sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018), KSHC bazuar në pikën 2.1. Neni 4 i Udhëzimit Administrativ për Akreditim (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018) dhe Standardeve dhe Udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG 2015), në mbledhjen e 63-të, mbajtur më 27 shkurt 2019, vendosi që Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) të iu lejohet/pranohet riorganizimi i stafit akademik bartës të programeve, të deklaruar në afatin kohor të përcaktuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018).

KSHC me vendim Nr.142/19H, datë 05.02.2019 ka tërhequr akreditimin e programeve si me poshtë:

1. Fakulteti i Edukimit: Pedagogji e Përgjithshme, BA, 180 ECTS; Programi Fillor, BA, 240 ECTS; Programi Parashkollor, BA, 240 ECTS, dhe Udhëheqja në Arsim, MA, 90 ECTS
2. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë: Menaxhimi i Biznesit në Zootekni, BSc, 180 ECTS;
3. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike: Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti, BSc, 180 ECTS;
4. Fakulteti i Mjekësisë: Infermieri, BSc, 180 ECTS;
5. Fakulteti Filozofik: Psikologji, BA, 180 ECTS, dhe Shkenca Politike, BA, 180 ECTS, dhe
6. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës: Gjeodezi, BSc, 180 ECTS.



Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KShC-së Nr.142/19D, datë 05.02.2019. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë 04 mars 2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës) dhe 131 (Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Përmes kësaj ankesa, Universiteti ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi rreth staf akademik për programin e studimit i cili ka qenë objekt i trajtimit me vendimin e KSHC-së Nr.142/19D, datë 05.02.2019.

Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 64-të të KShC-së, të mbajtur me 08 mars 2019, dhe në fund, KShC erdhi në përfundim që ankesa është e bazuar, dhe që stafi akademik i prezantuar përmes ankesës i plotësojnë kushtet për të qen bartës të programeve të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, dhe iniciimi i procedurave gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Universitetit i Prishtinës "Hasan Prishtina";
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë